



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK

TË DHËNA MBI VENDIMIN Nr. 52_ Datë 29.05.2018

MONITORIM I KRYER NGA APP

Autoriteti Kontraktor	SPITALI PSIKIATRIK "ALI MIHALI", VLORE
Hetim administrativ, iniciuar nga	• APP ☒ • Reklamim nga të tretë ☐
Numri i procedurave të monitoruara	1
Lloji i procedurës/ave të monitoruara	Negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës
Konstatimet kryesore	Nga shqyrtimi i gjithë informacionit të administruar në kuadër të hetimit administrativ dhe kundërshtimeve të dërguara nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Prokurimit Publik arrin në përfundimin se, autoriteti kontraktor nuk ka argumentuar dhe dokumentuar përlllogaritjen e fondit limit, duke vepruar në kundërshtim me nenin 28, pika 3, të ligjit të prokurimit publik dhe nenin 59 të rregullave të prokurimit publik. Autoriteti kontraktor nuk ka përdorur Dokumenta Standarde Tenderi për procedurën e prokurimit, objekt hetimi, në kundërshtim me nenin 41 të ligjit të prokurimit publik dhe nenin 36 të rregullave të prokurimit publik. Gjithashtu, autoriteti kontraktor nuk ka argumentuar dhe dokumentuar në një procesverbal, mënyrën e përzgjedhjes së operatorëve ekonomikë të ftuar për të marrë pjesë në procedurën e prokurimit, në kundërshtim me nenin 33, pika 6, të ligjit të prokurimit publik dhe 36, pika 4, të rregullave të prokurimit publik. Autoriteti kontraktor ka vepruar në kundërshtim me nenin 46 të ligjit të prokurimit publik, pasi për kriteret e kualifikimit të përcaktuara në dokumentat e tenderit (vërtetim për numër punonjësish, dokumentacion ku

ushtron aktivitetin shoqëria ofertuese dhe ku është instaluar Qendra e Monitorimit), nuk ka përcaktuar dokumentacionin konkret, që duhet të paraqesin ofertuesit, në përmbushje të kriteve të kualifikimit.

Gjithashtu, autoriteti kontraktor nuk ka kërkuar licencë për ushtrimin e aktivitetit për objektin e prokurimit, duke lejuar pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë që nuk janë të licencuar për realizimin e shërbimit të sigurisë fizike.

Autoriteti kontraktor ka kualifikuar dhe shpallur fitues operatorin ekonomik me mangësi në dokumentacion, në kundërshtim me kërkesat e kualifikimit dhe me nenet 53, pika 3, dhe 55, pika 2, të ligjit të prokurimit publik.

marra

Agjencia e Prokurimit Publik bazuar në nenet 13, pika 2/g/i, 66, dhe 72, pika 1, gërma, “dh”, “gj”, “i” të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar vendosi:

- Të penalizojë me gjobë, 4 (katër) persona, përkatësisht në cilësinë e anëtarëve të Njësisë së Prokurimit dhe grupit të punës për përllogaritjen e fondit limit;
- Të penalizojë me gjobë, 3 (tre) anëtarët e Komisionit të

Vlerësimi të Ofertave